REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1063/23
Datë/Datum. 05.01.2024
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1063
Data e Vendimit: 05.01.2024

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik CRYSTAL CLEAR SH.P.K., kundër Njoftimit të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE E OBJEKTEVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT" me numër të prokurimit 623-23-12928-2-1-1, inicuar nga Kuvendi Komunal Rahovec, në cilësinë e autoritetit kontraktues, Kryetari i Panelit Shqyrtues Vedat Poterqoi me datën 05/01/2024, mori këtë:

Vendim

1. **Hedhet si e palejuar**, ankesa e CRYSTAL CLEAR SH.P.K. me nr. të protokollit 2023/1063, e datës 29/12/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE E OBJEKTEVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT", me numër të prokurimit 623-23-12928-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Rahovec.

2. I lejohet, autoritetit kontraktues – Kuvendi Komunal Rahovec që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE E OBJEKTEVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT", me numër të prokurimit 623-23-12928-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 29.12.2023 ka pranuar ankesën me nr.1063/23 nga CRYSTAL CLEAR SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit "PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE E OBJEKTEVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT" me numër të prokurimit 623-23-12928-2-1-1, iniciuar nga Kuvendi Komunal Rahovec në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

Kuvendi Komunal Rahovec lidhur me aktivitetin e lartcekur me datë 29.11.2023ka publikuar B05 - Njoftimin për kontratë ndërsa me datën 20.12.2023 ka publikuar B54 Formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara dhe sipas këtij njoftimi afati i fundit për pranimin e tenderëve ka qenë data 29.12.2023.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit "PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE E OBJEKTEVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT" me numër të prokurimit 623-23-12928-2-1-1, Kuvendi Komunal Rahovecnë cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 - Njoftimin për kontratë me datën 29.11.2023, me datën 20.12.2023 ka publikuar B54 Formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, dhe sipas këtij njoftimi afati i fundit për pranimin e tenderëve ka qenë data 29.12.2023.

Zyra për pranimin e ankesave, pas pranimit të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka ofruar dëshminë se ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues siç kërkohet me nenin 108/A të LPP-së. Pra, Operatori ekonomik CRYSTAL CLEAR SH.P.K përmes parashtrimit të ankesës nuk ka ofruar edhe dëshmitë se ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë Autoriteti Kontraktues si dhe nuk ka ofruar dëshminë e pagesës siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së.

Konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datë 29.12.2023 nga OE CRYSTAL CLEAR SH.P.K për aktivitetin e prokurimit me titull"PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE E OBJEKTEVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT" me numër të prokurimit 623-23-12928-2-1-1, iniciuar nga Kuvendi Komunal Rahovec, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi nuk ka paraqitur në sistemin e – prokurimi dëshmi se ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues dhe nuk ka ofruar dëshminë e pagesës siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së. Andaj Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore pranë AK, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së.

Si përfundim kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 108/A, 109 dhe 111 Ligjit për Prokurim Publik, dhe nenit 65 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, dhe si e tillë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

I lejohet, autoritetit kontraktues – Kuvendi Komunal Rahovec që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE E OBJEKTEVE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT", me numër të prokurimit 623-23-12928-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- OE - **CRYSTAL CLEAR SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: